

Dy plumba makinës së 24-vjeçarit në Tiranë



16:07 03/03/2021

Policia gjen makinën e të riut të braktisur në lagjen “5 Maji”

24-vjeçari Nardi Abazi i ka shpëtuar një atentati, ku persona të paidentifikuar dyshohet se kanë qëlluar në drejtim të automjetit të tij tip Mercedes Benz. Ngjarja në fjalë është regjistruar rreth orës 22 të mbrëmjes së të martës në rrugën “5 Maji” në kryeqytet.

Automjeti në drejtim të të cilit u qëllua është gjetur rastësisht në vendin e ngjarjes nga patrullat e policisë që qarkullonin në zonë kryesisht në kuadër të orës policore. Sipas burimeve, në sallën operative të Policisë së Tiranës nuk ka pasur telefonatë për të shtëna.

Mjeti është gjetur i braktisur dhe pas verifikimeve të targës është konstatuar pronari, 24 vjeçari Nardi Abazi. Ky i fundit është fshehur në zonën e “5 Majit”, ndërsa kur pa konstatuar praninë e policisë tek mjeti i tij, është afruar, nga ku ka dhënë dhe versionin e tij për ngjarjen.

Ai ka treguar për hetuesit se po lëvizte në zonë kur në drejtim të mjetit të tij është qëlluar me dy plumba, nga pjesa e përparme e xhamit të parë dhe autorët janë larguar. Megjithatë nga këqyrja e vendit të ngjarjes është konstatuar se në drejtim të makinës së 24-vjeçarit të jetë qëlluar me 5 plumba por vetëm dy prej tyre kanë kapur xhamin e parë të makinës.

Hetimet po vijnë në disa drejtime, ndërsa janë ngritur disa pista. Grupi i punës dyshon për ndonjë konflikt i mundshëm që mund të ketë pasur 24-vjeçari në të kaluarën, pavarësisht se nuk rezulton të jetë ndaluar më parë dhe nuk ka precedent penal.

Në lidhje me ngjarjen janë shoqëruar disa persona për t’u marrë në pyetje, por akoma nuk ka të arrestuar si autorë të dyshuar. Megjithatë janë sekustruar dhe kamerat e sigurisë për të kontrolluar lëvizjet e mjeteve dhe të personave të tjerë në afërsi të vendit ku ka ndodhur ngjarja.

Klan News

TË NGJASHME



722 raste të reja dhe 9 viktima në RMV

22:20 06/03/2021



21 qytetarë humbën betejën me Covid-19, në 24 orë

16:59 06/03/2021

Rriten rastet e shtrimeve në spitalet Covid: Nga 638 të shtruar, 543 vetëm në Tiranë

14:19 06/03/2021

Nga një qytet në tjetrin, policia kap 2 hajdutët

12:30 06/03/2021

Rama tregon historinë: Politikani i rëndësishëm europian që kishte frikë të hynte në Tiranë

09:37 06/03/2021

Koalicion Rama-Basha pas zgjedhjeve? Shkullaku: Në politikë asgjë nuk është e pamundur

20:27 05/03/2021



511 pacientë në 4 spitalet Covid në Tiranë

15:45 05/03/2021



7 të vdekur nga Covid-19 në Kosovë në 24 orët e fundit

14:16 05/03/2021



7 dhe 8 Marsi nën monitorimin e policisë

13:15 05/03/2021

PROGRAME

OPINION

E DIELA SHQIPTARE

STOP

RUDINA

ZONË E LIRË

KLANIFORNIA

LOVE STORY

ALDO MORNING SHOW

AROMË DREKE

HISTORIA IME

JO VETËM MODË

HISTORI SHQIPTARE

KËNGA MAGJIKE

PRO BUSINESS

UNIKO

DIAGNOZË

LAJMET

ZGJEDHJET 2021

CORONAVIRUS

POLITIKA

EKONOMI

KRONIKË

AKTUALITET

KOSOVA

RAJONI

BOTA

TEKNOLOGJI

SPORT

SHOWBIZ

KURIOZITETE

SHËNDET

KULTURË

LIFESTYLE

TË TJERA

KLAN NEWS

KLAN PLUS

KLAN MACEDONIA

GUIDA

HOROSKOPI

MOTI

ANALIZA

LAJMET E FUNDIT

KALLËZO

EDICIONI INFORMATIV

LAJME NGA EMISIONET

LAJME NGA EDICIONET

LAJME LOVE STORY

KUICE

VIDEO

FOTOGALERI

ARKIVA KLAN 1998 -2012

SERIALE

DOKTORI I MREKULLIVE

OSMANI

SHTËPIA IME, FATI IM

VIKINGËT

KAMPIONI IM

LULE TË VETMUARA

ÇUKUR

KRYEQYTETI ABDULHAMID

LISTA E ZEZË

DYSHJA FANTASTIKE

KUZGUN (KORBI)

SULEJMANI I MADHËRISHËM

INTRIGAT E PUSHTETIT

NARCOS (TRAFIKANTËT)

BABIL (ZGJEDHJA)